

# RELACION

## PËR

### AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.137/2020, “PËR BUXHETIN E VITIT 2021, TË NDRYSHUAR”

#### A. MËNYRA E NDËRHYRJES

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijnë<sup>1</sup>:

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

#### **1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:**

Neni 101 ka parashikuar ‘nevojën’ dhe ‘urgjencën’ si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas vlerësimit të ecurisë 5.5-mujore të treguesve makro-fiskalë e buxhetorë, ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2021.

Ky rishikim i buxhetit 2021 propozohet t’i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, aspekti i nevojës dhe urgjencës të së cilit lidhet me:

- *akordimin e mbështetjes financiare për OSHEE, sh.a.-në, në formën e instrumentit të garancisë sovrane, me një vlerë 10 miliardë lekë për vitin 2021.*
- *rritjen e kufirit të huamarrjes neto vjetore për të akomoduar daljen me eurobond në tregjet ndërkombëtare, me një vlerë më të lartë se ajo e parashikuar fillimisht, pra nga 500 milionë euro në 700 milionë euro.*

#### **2. Përkohshmëria**

<sup>1</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 10.11.2006

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

## **B. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ AKTI NORMATIV**

Një nga dy qëllimet thelbësore të këtij akti normativ është financimi i mbështetjes financiare për OSHEE, sh.a.-në, në vijim edhe të miratimit të vendimit nr.584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”. Kjo, bazuar në argumentimet e dhëna nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përmes shkresës së saj nr.7467/1, datë 22.10.2021, (bashkëlidhur), në përcjellje të shkresës së OSHEE, sh.a.-së, nr.11172, datë 18.10.2021, (bashkëlidhur) dhe kërkesës përkatëse për mbështetje financiare.

Së dyti, ky akt normativ ka për qëllim akomodimin e daljes me Eurobond në tregjet ndërkombëtare me një vlerë më të lartë se ajo e parashikuar fillimisht, pra nga 500 milionë euro në 700 milionë Euro, përmes rritjes për këtë qëllim të kufirit të huamarrjes neto vjetore. Njëkohësisht, janë rishikuar dhe zërat e tjerë të financimit për të reflektuar situatën më reale referuar këtyre treguesve, konkretisht mbështetjeve buxhetore të pritshme e financimit të projekteve, dhe zëri i ripagesave të borxhit.

## **C. ARGUMENTIMI I HARTIMIT TË KËTIJ AKTI NORMATIV**

Ky akt normativ përcakton dy ndryshime kryesore, përkatësisht:

- akordimin e mbështetjes financiare për OSHEE, sh.a.-në, në formën e instrumentit të garancisë sovrane, me një vlerë 10 miliardë lekë për vitin 2021;
- rritjen e kufirit të huamarrjes neto vjetore për të akomoduar daljen me eurobond në tregjet ndërkombëtare me një vlerë më të lartë se ajo e parashikuar fillimisht, pra nga 500 milionë euro në 700 milionë euro.

Sa i takon mbështetjes fiannciare për OSHEE, sh.a.-në, bëjmë me dije se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përcjellje të kërkesës paraprirëse të OSHEE, sh.a.-së, ka paraqitur zyrtarisht pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesën për mbështetje financiare për periudhën 2021-2022, bazuar në argumentet e mëposhtme:

- *Rritja e menjëhershme e çmimeve në tregun e parregulluar të energjisë ka përkeqësuar performancën financiare të OSHEE, sh.a.-së, shoqëruar me pamundësinë e sigurimit të mjeteve financiare për blerjen e energjisë dhe vazhdimësinë e furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve.*
- *Gjendja e vështirë financiare më të cilën po përballlet shoqëria “OSHEE Grup” dhe sektori i energjisë elektrike, analizuar nga qeveria shqiptare u bë objekt i vendimit nr.584, datë 810.2021, të Këshillit të ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së*

*emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, ku në zbatim të pikës 4 të së cilit kërkohet mundësia e financimit prej 200 milionë eurosh.*

- *Përkatësisht, për vitin në vazhdim 2021 kërkohet financim i menjëhershëm i shoqërisë “OSHEE Grup”, në një vlerë prej 100 milionë eurosh, për përballimin e rritjes së çmimeve në tregun e parregulluar të energjisë dhe vazhdimin e furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve.*

Ndërkohë, sa i takon Eurobondit, rritja e vlerës së tij, që mund të emetohet në vitin 2021, vjen si rrjedhojë e një vlerësimi më real të nevojës për financim që do të mbulohej nga tregjet ndërkombëtare për vitet 2021 dhe 2022.

- *Dalja në vitin 2021 me një vlerë më të madhe do të mundësojë përballimin e nevojave edhe për vitin 2022, për rrjedhojë një emetim tjetër gjatë 2022 nuk do jetë më i nevojshëm.*
- *Ky vlerësim mbështetet edhe nga kushtet aktuale të tregjeve të kapitalit ku ka likuiditet të konsiderueshëm dhe norma interesi akoma të ulëta, si rrjedhojë e politikave lehtësuese të Bankës Qendrore Evropiane apo Rezervës Federale, e, për rrjedhojë, konsiderohet i rëndësishëm shfrytëzimi i kushteve të favorshme të tregjeve financiare aktualisht.*

Sa i takon borxhit publik, miratimi i garancisë së sipërcituar në vlerën 10 miliardë lekë për vitin 2021, rritja e vlerës së Eurobondit si dhe ndryshime të tjera të mundësuar, implikojnë një rritje në nivelin e borxhit publik me 38.9 miliardë lekë.

Ndryshimet e propozuara përmes këtij akti normativ nuk prekin treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore të cilat nuk kanë pësuar ndryshime në këtë akt normativ. Rrjedhimisht, niveli i deficitit buxhetor mbetet i pandryshuar.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**